



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E AUDITIT TE BRENDSHËM

Nr. 12570/prot.

Durrës, më 17.10.2025

MIRATOHET
KRYETAR

Emiriana Sako



Lënda: Plani vjetor për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Durrës për periudhën 01 Janar -31 Dhjetor 2026

1. Zhvillimi aktual i NJAB

Njësia e Auditimit të Brëndshëm pranë Bashkisë Durrës është krijuar dhe zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr.114 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligj nr. 12, datë 2.02.2023 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin 114, datë 22.10.2015, Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manualit të Auditimit të Brendshëm”, i ndryshuar miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr.100 datë 25.10.2016, të Ligjit 139 datë 17.12.2015 “Per vëteqeverisjen vendore”, si dhe rregullores së brendshme të funksionimit të institucionit.

Kjo Njësi po e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të planit strategjik, planit vjetor të auditimi për vitin 2025, miratuar nga Kryetari i Bashkisë me shkresën nr.11308/2 datë 21.10.2024.

Plani vjetor 2026 u hartua në bazë të planit strategjik 2026-2028 të aktiviteteve të auditimit të brendshëm, i cili përkufizon tematikën e veprimtarisë, hapësirat e veprimt në perspektivë , prioritetet në pajtueshmëri me qëllimet e Subjekteve që auditohen, drejtimet strategjike të zhvillimit të kontrollit të brendshëm, objektin, objektivat, kohëzgjatjen dhe burimet e nevojshme për kryerjen e secilës detyrë të auditimit.

Plani Vjetor mund të rishikohet rregullisht gjatë vitit dhe të azhurnohet sipas nevojës, në mënyrë që t'i pasqyrojë ndryshimet e rëndësishme që ndodhin në Bashkinë Durrës, si dhe çdo detyrë shtesë të propozuar nga Titullari i Bashkisë. Ndryshimi i Planit Vjetor miratohet nga Kryetari i Bashkisë.

Ne zbatim të planit vjetor për periudhën Janar-Shtator 2025, Njësia e Auditimit të Bashkisë Durrës ka kryer misione auditimi në subjektet e varësisë dhe në vetë sektorët e Bashkisë.

Subjektet e audituara janë:

1.Policia Bashkiake	Auditim përputhshmërie
2.Zbatim Rekomandime NJAB	Auditim përputhshmërie
3.Ndërmarrja Shërbim Komunale Durrës	Auditim financiar & përputhshmërie
4.Ndërmarrja Komunale Plazh	Auditim financiar & përputhshmërie
5.Qendra Ekonomike Arsimit Durrës	Auditim financiar & përputhshmërie
6.Ndërmarrja Rruga	Auditim financiar & përputhshmërie
7.Ndërmarrja Shërbim Komunale Durrës (me urdhër)	Auditim përputhshmërie

Gjatë periudhës raportuese nëntë mujore të vitit 2025, realizimi i misionëve të auditimit është përmbushur në masën **100%**, në përputhje me numrin e subjekteve të planifikuara për t'u audituar sipas planit vjetor të miratuar.

Në analizë të mëtejshme të realizimit të planit, konstatohet se janë evidentuar ndryshime në përbërjen e subjekteve dhe në natyrën e angazhimeve të kryera, krahasuar me planifikimin fillestar. Më konkretisht, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, është zhvilluar auditimi në Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale Durrës.

Auditimet e realizuara gjatë periudhës raportuese kanë evidentuar, në përgjithësi, përpjekje të vlerësueshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe përmirësimin e praktikave institucionale. Megjithatë, janë konstatuar edhe veprime apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullative përkatëse. Për këto raste, në përfundim të misionëve të auditimit janë lënë rekomandime , të cilat synojnë korrigjimin e parregullsive të konstatuara, forcimin e mekanizmave të brendshëm të kontrollit, si dhe rritjen e efektivitetit dhe transparencës në administrimin e burimeve publike si më poshtë:

1.Policia Bashkiake	7 rekomandime
2.Zbatim Rekomandime NJAB	1 për ndjekje të rekomandimeve të pazbatuara
3.Ndërmarrja Shërbim Komunale Durrës	7 rekomandime
4.Ndërmarrja Komunale Plazh	6 rekomandime
5.Qendra Ekonomike e Arsimit	6 rekomandime
6.Ndërmarrja Rruga	13 rekomandime
7.Ndërmarrja Shërbim Komunale Durrës (me urdhër)	7 rekomandime

2.Prioritetet e auditimit

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar prioritetet e saj në lidhje me përmirësimin e punës audituese, të cilat konsistojnë në :

-Gjykimin dhe punën tonë ta bazojmë në informacionin faktik dhe të paanshëm.

-Identifikimin dhe vlerësimin e riskut, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të

menaxhimit të riskut;

-Te ndihmojë njësitë e sektorit publik për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve, kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmerinë dhe kursimin e burimeve (ekonominë, eficientë dhe efektivitetin);

-Te jape siguri objektive për titullarët e subjekteve që auditohen, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare.

-Të ndihmojë menaxhimin e sektorit publik në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe shërbimet e njësisë;

-Të pengojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim;

-Të ndihmojë punonjësit të përmirësojnë performancën e tyre të punës dhe në respektimin e kontrolleve të vendosura.

Prioritetet e saj synon ti arrijë nëpërmjet :

-Planifikimit të veprimtarisë audituese, planit strategjik e vjetor, në mënyrë që ai të jetë i zbatueshëm.

-Nivelit të lartë profesional të stafit të NJAB

-Zbatimit të standarteve ku mbështetet kjo veprimtari auditimi.

-Komunikimit dhe monitorimit me strukturën e NJQH për auditimin e brendshëm

-Trajnimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që çdo auditues të përditësojë njohuritë dhe aftësitë e veta mbi ndryshimet e fundit, përmirësimet, standardet e auditimit dhe këshillat praktike mbi teknikat dhe praktikën e reja të auditimit.

3.Objektivat kryesore për vitin 2026

Objektivi i punës së Njesisë së Auditimit të Bashkisë Durrës është që të përcaktojë nëse proceset e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes të hartuara dhe paraqitura nga menaxhimi, janë të sakta, të zbatueshme dhe funksionojnë në atë mënyrë që të garantojnë përsosjen e veprimtarisë audituese nga ana cilësore, të përcaktojë dhe vlerësojë nëse objektivat janë arritur në përputhje me misionin që ka subjekti që auditohet dhe se:

- Risku identifikohet dhe menaxhohet në mënyrën e duhur.
- Informacioni thelbësor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë.
- Veprimet e punonjësve janë të zbatueshme në përputhje me politikat, standardet, procedurat, rregulloret dhe ligjet .
- Burimet sigurohen me ekonomikitet, përdoren me eficientë dhe mbrohen me korrektësi.
- Programet, planet dhe objektivat , realizohen.
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm.
- Cështjet e rëndësishme legislative që kanë ndikim në subjekt janë pranuar dhe adresuar sic duhet.

4-Programi i llojeve te angazhimit

Nr.	SUBJEKTET	FUSHA AUDITIMIT	NR. AUDIT	LLOJI ANGAZHIMIT
1	Drejtoria Ekonomike	Operacionet+Pasqyrat Financiare	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
2	Qendra Ekonomike e Arsimit	Sistemi i kontrollit të brendshëm Përmirësimi i cilësisë së shërbimit Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar Sistemi i veprimeve me likuiditetet për paradhëniet Sistemi i prokurimeve publike Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve Sistemi i te drejtave dhe detyrimeve	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
3	Ndërmarrja. Sherbimeve Komunale	Sistemi i zbatimit të rekomandimeve	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
		Sistemi i kontrollit të brendshëm		
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i prokurimeve publike		
		Sistemi i menaxhimit të karburantit		
		Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve		

		Sistemi I drejtimit ekonomik		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
4	Ndërmarrja e Rrugeve	Sistemi i zbatimit të rekomandimeve	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
		Sistemi i kontrollit të brendshëm		
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i prokurimeve publike		
		Sistemi i menaxhimit të karburantit		
		Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
		Sistemi i të ardhurave dytësore nga qiratë e vendstrehimeve		
5	Agjencia e Parqeve Urbane	Sistemi i zbatimit të rekomandimeve	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
		Sistemi i kontrollit të brendshëm		
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i prokurimeve publike		
		Sistemi i menaxhimit të karburantit		
		Sistemi i pagave dhe numrit të		

		punonjesve		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
6	Ndërmarrja Komunale Plazh	Sistemi i zbatimit të rekomandimeve	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
		Sistemi i kontrollit të brendshëm		
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i prokurimeve publike		
		Sistemi i menaxhimit të karburantit		
		Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
		Sistemi i zbatimit të rekomandimeve		
		Sistemi i kontrollit të brendshëm		
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
7	Qendra Ditore e te Moshuareve	Sistemi i kontrollit të brendshëm	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar)
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi i menaxhimit të		

		aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
8	Qendra Kulturore Durrës	Sistemi i kontrollit të brendshëm	1	Auditim i kombinuar (përputh & financiar
		Përmirësimi i cilësisë së shërbimit		
		Sistemi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit		
		Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar		
		Sistemi i veprimeve me thesarin dhe arkën		
		Sistemi i të ardhurave dytësore		
		Sistemi i prokurimeve publike		
		Sistemi menaxhimit të aktiveve qarkulluese dhe afatgjata		
		Sistemi i pagave dhe numrit të punonjësve		
		Sistemi i të drejtave dhe detyrimeve		
9	Zbatim Detyrash KLSH	Zbatimi i rekomandimeve lene nga KLSH	1	Auditim përputhshmërie
10	Zbatim Detyrash NJAB	Zbatimi i rekomandimeve ne auditimet e meparshme	1	Auditim përputhshmërie
11	Drejtoria Ligjore Manaxhimi Pronave dhe pyjet	Menaxhimi i Pronave dhe pyjet	1	Auditim përputhshmërie
		Ligjshmëria ,Ndjekja e Proced., Përfaqësimi në Procese Gjyqësore		
		Procedura e Gjendjes Civile		

5. Planifikimi i kostos dhe burimeve

Planifikimi i kostos dhe burimeve është një aktivitet që fillon me planifikimin e auditimeve për vitin pasardhës. Drejtuesi i NJAB-së përllëgarit përafërsisht numrin e ditëve të punës që nevojiten për të përmbushur objektivat e caktuara të cilat paraqiten më

të detajuara në planin vjetor. Kjo llogaritje bazohet në të dhëna si p.sh. sa kohë u shpenzua për auditimin e fundit në atë fushë, duke përdorur gjykim profesional pas analizimit të dy faktorëve kryesorë, kompleksitetit të fushës / sistemit që duhet shqyrtuar, si dhe përvojës profesionale të audituesve të brendshëm.

Në planifikim Drejtuesi i NjAB-së realizon shpërndarjen sa më efikente të burimeve në dispozicion në varësi të kërkesave për realizimin e planit. Shpërndarja e burimeve raporti ditë/person nuk bëhet në mënyrë të barabartë për auditime të ndryshme, pasi sisteme/fusha komplekse kërkojnë më shumë burime dhe kohë për tu audituar, ndërkohë që audituesve me përvojë iu duhet më pak kohë në krahasim me audituesit e rinj për të menaxhuar të njëjtin angazhim auditimi apo për angazhime të ngjashme. Në përputhje me strategjinë e auditimit, me burimet e mundshme Drejtoria e Auditimit të Brendshëm përllogarit kohën efektive të punës së çdo audituesi. Sipas strukturës së miratuar nga kryetari i Bashkisë Durrës me vendim nr.04 prot.325 datë 09.01.2025, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga pesë punonjës (1+4), një drejtor dhe katër specialistë, por aktualisht kjo njësi funksionon me një drejtor dhe tre specialistë. Referuar numrit aktual të audituesve (1+3), për një vit burimet e mundshme do të jenë:

-Planifikimi i burimeve:

Nr	BURIMET E PLANIFIKUARA		
	SHPERNDARJA E BURIMEVE NJEREZORE TE NJAB	DITE PER TREGUES	PERLLOGARITJA E BURIMEVE
1	Koha maksimale e vlefshme	1040	52 javë x 5 ditë x 4 persona
2	Pushime Vjetore	88	22 ditë x 4 persona
3	Ditë pushimi (Festa Zyrtare)	64	15 ditë x 4 persona
4	Pushime për arsye shëndetësore	20	5 ditë x 4 persona
5	Angazhime në trajnime	40	10 ditë x 4 persona
6	Angazhime në mbledhje/takime	16	4 ditë x 4 persona
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	40	10 ditë x 4 persona
	TOTALI	772	193 ditë/person

-Planifikimi i kostos

Nr	BUXHETI I PLANIFIKUAR	
	TREGUESIT E KOSTOS SE BURIMEVE NJEREZORE	PLANI
1	Buxheti Gjithsej	6.614.600
2	Paga dhe Sig.Shoqërore	6.564.600
3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta	34.000
4	Të tjera	16.000
5	Numri i Punonjësve	4
6	Kosto për Person (1/4)	1.653.650

6.Planifikimi i nevojave për trajnim

Nga struktura jonë është kërkuar mundësia e pjesëmarrjes së stafit në trajnime të vazhdueshme që organizon NJQH për Audituesit e Brendshëm, dhe pjesëmarrja në trajnimet e organizuara vazhdimisht ka qenë 100%, e gjithë kjo për rritjen e performancës së audituesve.

Nga ana jonë propozojmë trajnime me temat si më poshtë :

-Sistemi i prokurimeve publike

- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit

7.Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Njësia e Auditimit pranë Bashkisë Durrës, aktualisht funksionon me 4 punonjës (1+3) në strukturën e miratuar me 5 punonjës (1+4). Sigurimi i brendshëm i cilësisë kryhet në bazë të programit, miratuar nga Titullari i Bashkisë me nr.11138/1prot. datë 30.09.2024, i cili përbëhet nga vlerësimet e brendshme që përfshijnë : Vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm (nga drejtuesi i NJAB dhe punonjësi më me eksperiencë).

Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe performancës së auditimit të brendshëm përcakton nëse procedurat janë zbatuar në përputhje me standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, kartën, rregulloren e brendshme, kodin e etikës dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e auditimit të brendshëm.

Programi i sigurimit të brendshëm të cilësisë përbëhet nga 3 komponentë:

- monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë;
- vetë-vlerësimi periodik;
- Reagimi i subjektit të audituar

DREJTOR NJAB

Oneda Deliallisi

